

Raporti Vjetor Narrativ

Viti 2025

Zbatuar nga YWCA of Albania

www.ywca-albania.al

www.fjongoroze.al

 [ywcaalbania](https://www.instagram.com/ywcaalbania)



YWCA of Albania / Shoqata Kristiane

Adresa: Rr. Him Kolli, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00355 42271642

Email: administratore@ywca-albania.al

HYRJE

YWCA of Albania mbetet e përkushtuar ndaj misionit të saj për fuqizimin e grave, vajzave, të rinjve dhe fëmijëve, si dhe për forcimin e komuniteteve përmes ndërhyrjeve gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të bazuara në të drejta. Gjatë vitit 2025, YWCA vijoi të shërbejë si një hapësirë e sigurt, mbështetëse dhe dinamike për individë nga prejardhje të ndryshme, duke adresuar sfida kyçe shoqërore që lidhen me barazinë gjinore, shëndetin, arsimin, përfshirjen sociale, mirëqenien psiko-emocionale dhe përgjegjshmërinë mjedisore.

Duke u mbështetur në prioritetet e saj strategjike, YWCA u fokusua në mbështetjen e grupeve vulnerable, përfshirë gratë që përballen me sfida shëndetësore dhe socio-ekonomike, fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, komunitetet refugjate dhe familjet në nevojë për mbrojtje dhe kujdes. Qasja e YWCA gjatë gjithë vitit u përqendrua në zhvillimin e leadershipit, aksesin në shërbime cilësore, mbështetjen psikosociale, angazhimin komunitar dhe advokacinë, duke krijuar njëkohësisht partneritete të reja me institucionet kombëtare, organizatat ndërkombëtare, pushtetin vendor dhe aktorë të shoqërisë civile.

Një shtyllë qendrore e punës së YWCA në vitin 2025 ishte gjithashtu promovimi i dinjitetit njerëzor, barazisë dhe qëndrueshmërisë. Përmes programeve arsimore, fushatave ndërgjegjëse, iniciativave për ndërtimin e kapaciteteve dhe ofrimit të shërbimeve direkte, organizata kontribuoi në forcimin e kapaciteteve individuale dhe strukturave komunitare, duke garantuar që askush të mos mbetet pas.

Ky raport vjetor paraqet një pasqyrë të programeve dhe projekteve kryesore të YWCA of Albania të zbatuara gjatë vitit 2025, duke theksuar arritjet, impaktin dhe mësimet e nxjerra. Këto arritje pasqyrojnë përkushtimin e stafit, vullnetarëve, bordit drejtues, partnerëve dhe donatorëve të YWCA, mbështetja e vazhdueshme e të cilëve e bëri të mundur këtë punë.

QËLLIMI 1: TË VAZHDOJË TË PROMOVOJË ROLIN E LIDERSHIPIT TË GRAVE SHQIPTARE PËRMES INFORMIMIT, EDUKIMIT DHE PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

Projekti 1.1 “Gratë dhe të rinjtë - kujdestarë të tokës”

YWCA of Albania, me mbështetjen e *BOOST Balkans*, ka filluar zbatimin e këtij projekti në tetor 2025, si një ndërhyrje e integruar që synon fuqizimin e grave dhe të rinjve të zonave rurale, me fokus të veçantë tek vajzat e reja, për të ndërmarrë role aktive udhëheqëse në mbrojtjen e mjedisit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe vendimmarrjen lokale në komunitetet e tyre.

Projekti po zbatohet në bashkitë *Berat dhe Shkodër* dhe qëllimi kryesor i tij është *fuqizimi i grave dhe të rinjve të zonave rurale si liderë komunitarë dhe mbrojtës aktivë të tokës*, duke rritur kapacitetet e tyre për veprim klimatik, menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe advokim mjedisor në nivel lokal.

Projekti ndërthur barazinë gjinore, ndërgjegjësimin për mjedisin dhe zhvillimin rural, duke promovuar modele të reja bashkëpunimi ndërbrezor dhe duke e pozicionuar komunitetin si aktor kyç në zgjidhjen e problematikave mjedisore.

➤ *Përshkrimi i aktiviteteve dhe progresi*

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2025, fokusi kryesor ishte krijimi i grupeve lokale, mobilizimi i komunitetit dhe përgatitja për fazën e trajnimeve.

Në këtë fazë:

- u zhvilluan takime orientuese dhe konsultuese në komunitetet rurale të Beratit dhe Shkodrës;
- u identifikuan përfituesit kryesorë të projektit, duke garantuar përfaqësim gjinor dhe ndërbrezor;
- u krijuan grupet lokale Eco-Action në secilën zonë, të përbëra nga gra dhe të rinj që do të punojnë së bashku përgjatë gjithë projektit;

- u hartua plani i detajuar i trajnimeve dhe metodologjia e ndërhyrjes.

Deri në fund të dhjetorit 2025, janë krijuar 4 grupe, të cilat përfaqësojnë një kombinim të qëllimshëm të grave rurale dhe të rinjve, duke nxitur bashkëpunimin ndërbrezor dhe ndarjen e njohurive tradicionale me energjinë dhe perspektivën e brezit të ri. Paralelisht, ka filluar procesi i trajnimit të 80 grave dhe 30 të rinjve nga të dyja zonat, i cili do të vijojë përgjatë fazave të ardhshme të projektit.

➤ ***Rezultatet e pritshme***

- **110 liderë lokalë të trajnuar** në veprim klimatik dhe advokim mjedisor (80 gra, 30 të rinj);
- **4 grupe aktive Eco-Action & Advocacy** në Berat dhe Shkodër;
- të paktën **2 dialogje politike me bashkitë**, me propozime konkrete për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- mbi **500 anëtarë komuniteti të angazhuar** përmes aktiviteteve ndërgjegjëse;
- një **raport përfundimtar** me praktika të mira dhe histori suksesi për replikim.

Në tërësi, “*Gratë dhe të rinjtë - kujdestarë të tokës*” synon të krijojë komunitete rurale më të qëndrueshme, më të organizuara dhe më të afta për të mbrojtur tokën, burimet natyrore dhe të ardhmen e tyre.

Foto nga aktivitetet



QËLLIMI 2: TË VAZHDOJË TË MUNDËSOJË INFORMIMIN, EDUKIMIN DHE TRAJNIMIN E GRAVE DHE VAJZAVE, PËR T'I FUQIZUAR ATO NË ASPEKTIN KULTUROR DHE SOCIAL

Projekti 2.1: EmpowerHer – Të rejat udhëheqin veprimin klimatik për një të ardhme të qëndrueshme

Ky projekt u zbatua nga YWCA of Albania me mbështetjen e *World YWCA*, gjatë periudhës nëntor 2024 – shtator 2025, në qytetet *Tiranë, Berat dhe Shkodër*. Projekti synoi fuqizimin e vajzave dhe grave të reja të moshës 18–30 vjeç për të marrë role aktive udhëheqëse në veprimin klimatik, përgjegjshmërinë mjedisore dhe angazhimin komunitar, duke lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë barazinë gjinore me sfidat e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Projekti përfshiu **90 vajza dhe të reja** nga tre qytetet përfituese, të cilat u angazhuan fillimisht në sesione orientuese dhe më pas në një cikël të strukturuar trajnimesh mbi leadershipin, veprimin klimatik, organizimin komunitar dhe advokimin. Trajnimet u zhvilluan bazuar në *RiseUp! Leadership Guide dhe Metodologjinë e Konsultimit Feminist* të World YWCA, duke përdorur metoda interaktive si workshope praktike, diskutime në grup, reflektime individuale, ushtrime kreative dhe simulime. Kjo qasje kontribuoi jo vetëm në rritjen e njohurive teknike, por edhe në zhvillimin e vetëbesimit, aftësive të komunikimit dhe mendimit kritik të pjesëmarrëseve.

Pas fazës së ndërtimit të kapaciteteve, vajzat u organizuan në grupe pune dhe u angazhuan në procesin e bashkë-krijimit të iniciativave komunitare mjedisore. Gjatë këtij procesi, ato identifikuan problematika konkrete mjedisore në komunitetet e tyre, si ndotja nga mbetjet, mungesa e riciklimit, ndotja plastike dhe mungesa e ndërgjegjësimit mbi ndryshimet klimatike. Si rezultat, u dizajnuan dhe u zbatuan **6 iniciativa komunitare të udhëhequra nga vajzat**, të cilat përfshinë:

- fushata lokale për reduktimin e mbetjeve dhe ndarjen e tyre;
- aktivitete riciklimi dhe ndërgjegjësimi në shkolla dhe komunitete;
- iniciativa gjelbërimi dhe mbjellje pemësh në hapësira publike;
- krijimin e klubeve rinore mjedisore;
- workshope edukative mbi klimën, qëndrueshmërinë dhe konsumin e përgjegjshëm;
- aktivitete informuese dhe fushata online për rritjen e ndërgjegjësimit publik.

➤ **Rezultate dhe impakt**


- **90 vajza dhe gra të reja** u trajnuan dhe u fuqizuan

- **6 iniciativa komunitare mjedisore u zbatuan** me sukses në Tiranë, Berat dhe Shkodër.
- Mbi **2,000 anëtarë të komunitetit përfituan** drejtpërdrejt nga aktivitetet publike, workshopet, fushatat ndërgjegjëse dhe eventet komunitare.
- **U rrit ndjeshëm vetëbesimi dhe aftësia e pjesëmarrëseve për të folur në publik**, për të udhëhequr procese dhe për të bashkëpunuar me aktorë lokalë.
- **U krijuan rrjete të reja bashkëpunimi** mes të rejave, shkollave, pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile.

Në tërësi, “EmpowerHer” kontribuoi në krijimin e një modeli të qëndrueshëm, rinor dhe feminist të veprimit klimatik në Shqipëri. Projekti dëshmoi se investimi tek vajzat e reja sjell ndikim të shumëfishtë – duke forcuar komunitetet, duke nxitur veprimin klimatik dhe duke ndërtuar lidhshmëri të ri, të angazhuar dhe të vetëdijshëm për drejtësinë sociale dhe mjedisore.

Foto nga aktivitetet





Projekti 2.2: Eco-Girls+: Ndërtojmë ekonomi qarkulluese me barazi që në shkollë

Ky projekt u zbatua nga YWCA of Albania me mbështetjen e *EDEN Center* në qarkun Shkodër, gjatë periudhës shtator 2025 – janar 2026, me qëllim fuqizimin e vajzave adoleshente për të vepruar si lidere të ndryshimit mjedisor dhe social brenda komuniteteve të tyre shkollore. Projekti u zhvillua në dy institucione arsimore: gjimnazin “28 Nëntori” në Shkodër dhe shkollën e mesme të bashkuar “Adem Haxhija” në Postrinë, duke ndërthurur edukimin mjedisor me barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen aktive të vajzave në vendimmarrje.

Objektivat specifike përfshinë:

- rritjen e njohurive dhe aftësive të vajzave mbi ekonominë qarkulluese, riciklimin dhe ripërdorimin;
- zhvillimin e aftësive të lidershit, organizimit dhe vendimmarrjes;
- krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm mjedisorë në shkollë;
- nxitjen e kreativitetit dhe inovacionit përmes artit dhe ripërdorimit të materialeve;
- përfshirjen aktive të komunitetit shkollos në praktika të qëndrueshme.

Në fazën fillestare, vajzat morën pjesë në *workshope edukative dhe kreative* mbi ekonominë qarkulluese, përgjegjshmërinë mjedisore dhe barazinë gjinore. Këto sesione u konceptuan si hapësira bashkëpunimi dhe reflektimi, ku vajzat jo vetëm morën njohuri teorike, por u inkurajuan të ndajnë përvoja, të identifikojnë problematika konkrete në shkollat e tyre dhe të propozojnë zgjidhje praktike. Metodologjia e përdorur ishte pjesëmarrëse dhe e fokusuar tek vajzat si aktore kryesore të ndryshimit.

✓ **Krijimi i kioskave “Eco Corner”**

Një nga rezultatet më të rëndësishme dhe të qëndrueshme të projektit ishte krijimi dhe funksionalizimi i dy kioskave “Eco Corner”, nga një në secilën shkollë. Këto hapësira u konceptuan si pika shkëmbimi materialeve dhe si qendra edukative për ekonominë qarkulluese. Vajzat u angazhuan drejtpërdrejt në:

- planifikimin e hapësirës;
- ndarjen e roleve dhe përgjegjësi;
- hartimin e rregullores së funksionimit;
- menaxhimin dhe promovimin e kioskës brenda shkollës.

“Eco Corner” shërben si një mekanizëm praktik ku nxënësit mund të sjellin materiale që nuk i përdorin më dhe t’i shkëmbejnë, duke nxitur ripërdorimin, solidaritetin dhe reduktimin e mbetjeve. Përmes këtij procesi, vajzat ushtruan në mënyrë konkrete aftësi organizative, planifikuese dhe vendimmarrëse, duke u shndërruar në menaxhere aktive të një strukture funksionale brenda shkollës.

✓ **Fushata “Mblidh, mos hidh” dhe aktivitetet kreative**

Në kuadër të projektit u zhvillua fushata sensibilizuese “*Mblidh, mos hidh*”, e cila përfshiu mbledhjen e materialeve të riciklueshme dhe përdorimin e tyre në punime kreative. Vajzat realizuan objekte artistike dhe funksionale si veshje, çanta, aksesorë, sende dekorative, sapunë dhe produkte të tjera, duke demonstruar në mënyrë konkrete potencialin e ripërdorimit.

Element kyç ishte organizimi i ekspozitës “*Nga mbetje në art*” në të dyja shkollat. Ekspozitat u konceptuan si evente interaktive, ku vajzat prezantuan punimet e tyre, organizuan kuize, lojëra edukative, aktivitete kreative dhe prezantime për nxënësit e tjerë. Në këto aktivitete morën pjesë dhjetëra nxënës, mësues dhe prindër, duke e kthyer ekspozitën në një hapësirë dialogu, frymëzimi dhe reflektimi mbi konsumin e përgjegjshëm.

✓ **Vizita ndërshkollore dhe shkëmbimi i përvojave**

Një komponent i rëndësishëm i projektit ishte organizimi i vizitave ndërshkollore, ku vajzat nga dy shkollat patën mundësi të ndajnë përvoja, të mësojnë nga njëra-tjetra dhe të forcojnë ndjenjën e rrjetëzimit. Këto aktivitete kontribuan në ndërtimin e një komuniteti vajzash të angazhuara, të cilat e shohin veten si pjesë të një lëvizjeje më të gjerë për ndryshim.

➤ **Rezultate dhe impakt**

- **60 vajza të trajnuara dhe të fuqizuara** në ekonomi qarkulluese, lidërsip dhe kreativitet.
- **2 kioska “Eco Corner” funksionale** dhe të menaxhuara nga vajzat.
- **4 workshope kreative, 2 ekspozita shkollore dhe fushata sensibilizuese** të realizuara me sukses.
- **Rreth 500 përfitues të tërthortë** në komunitetin shkollor.
- **Rritje e ndjeshme e vetëbesimit, iniciativës dhe rolit udhëheqës** të vajzave brenda shkollave.
- **Krijimi i praktikave të qëndrueshme** që vazhdojnë edhe pas përfundimit të projektit.

Në përfundim, “Eco-Girls+” dëshmoi se kur vajzave u jepet hapësirë, besim dhe mjete praktike, ato janë në gjendje të udhëheqin procese reale ndryshimi. Projekti krijoi jo vetëm rezultate të prekshme mjedisore, por edhe transformime sociale dhe kulturore, duke ndërtuar një brez vajzash më të vetëdijshme, të angazhuara dhe të gatshme për të ndikuar pozitivisht në komunitetet e tyre.

Foto nga aktivitetet







Projekti 2.3: Zgjerimi dhe përmirësimi i programit të shërbimit të bibliotekës

Projekti i Bibliotekës lidhet me qëllimet kryesore të YWCA për emancipimin e grave dhe vajzave duke promovuar pasionin për leximin e librave, si një formë trajnimi për të mundësuar rritje kulturore dhe sociale, por gjithashtu edhe për të sjellë ndryshime pozitive në jetën e tyre. Biblioteka e YWCA përmban libra të kategorive të ndryshme: libra klasikë, libra nga autorë shqiptarë, libra psikologjikë, filozofikë dhe sociologjikë; libra mjekësorë; libra në gjuhë të huaj, libra historikë, etj. Një fokus të rëndësishëm në bibliotekën tonë, kanë librat për fëmijë, me tregime dhe përralla, por edhe me udhëzime për prindërit dhe mësuesit, për rritjen e shëndetshme dhe edukimin. Në bibliotekën tonë, mund të keni akses tek autorët më të mirë shqiptarë dhe të huaj. Aktualisht biblioteka ka **3,500** libra.

Librat kanë një *ndikim të madh në fuqizimin e grave dhe vajzave* sepse ndikojnë pozitivisht në aspektin emocional dhe psikologjik; japin mundësi për të mësuar gjëra të reja, për të eksploruar ide të reja, si dhe për të zgjeruar njohuritë. Projekti i Bibliotekës synon të përmirësojë shëndetin emocional të lexuesve, pasi librat karakterizohen nga prania e shumë emocioneve. Gratë kanë nevojë për akses në libra që nxisin imagjinatën e tyre dhe u ngjallin interes, në mënyrë që të nxiten që të vazhdojnë të lexojnë përgjatë gjithë jetës së tyre. YWCA do të vazhdojë të vendosë një fokus të veçantë në *edukimin e grave dhe vajzave, si mënyra kryesore për t'i fuqizuar ato*.



QËLLIMI 3: TË OPEROJË SI NJË NGA ENTITETET MË TË MIRA NË PRAKTIKË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ARSIMIT CILËSOR PËR FËMIJËT

Projekt 3.1: “Qendrat e Fëmijërisë së Hershme, si hapësira të sigurta dhe kreative!”

Ky projekt u zbatua nga YWCA gjatë periudhës **2022–2025**, me mbështetjen e *UNICEF dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara*. Përgjatë këtij cikli disavjeçar, iniciativa përfaqësoi një ndërhyrje të qëndrueshme dhe të strukturuar, e orientuar drejt garantimit të të drejtës për arsim cilësor, mbrojtje dhe mirëqenie për fëmijët në fëmijërinë e hershme, veçanërisht për fëmijët refugjatë afganë dhe familjet e tyre të strehuara përkohësisht në Shëngjin. Projekti u konceptua si një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj nevojave komplekse të fëmijëve të prekur nga zhvendosja, trauma dhe pasiguria, duke kombinuar arsimin joformal, mbështetjen psikosociale, fuqizimin prindëror dhe ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve të arsimit.

Në qendër të projektit ishte Qendra Ditore në Shëngjin, e cila për vite me radhë ofroi një paketë të integruar shërbimesh arsimore dhe psikosociale. Aktivitetet edukative u bazuan në qasje joformale, të mësuarit përmes lojës dhe praktika të ndjeshme ndaj traumës, duke mbështetur zhvillimin njohës, emocional, social dhe fizik të fëmijëve. Programet tematike mujore integruan tregimin e historive, artin kreativ, muzikën dhe lëvizjen, lojërat shqisore, aktivitetet në grup, zhvillimin e inteligjencës emocionale dhe elemente shumëgjuhëshe, për të nxitur komunikimin, vetë-shprehjen dhe përfshirjen.

Shërbimet dhe aktivitetet kryesore të ofruara

- *Aktivitete edukative joformale dhe të bazuara në lojë për fëmijët parashkollorë.*
- *Mbështetje psikosociale dhe këshillim për fëmijët dhe prindërit.*
- *Terapi përmes artit dhe lojës, si instrumente shprehjeje dhe shërimi emocional.*
- *Takime informuese dhe ndërgjegjësuere me prindërit mbi zhvillimin e fëmijëve.*
- *Krijimi dhe funksionimi i Klubit të Prindërve si hapësirë për mbështetje reciproke.*
- *Workshope tematike për prindërit mbi prindërimin pozitiv, mirëqenien emocionale, menaxhimin e sjelljes dhe barazinë gjinore.*
- *Trajnime, mentorim dhe mbështetje profesionale për stafin e Qendrës Ditore.*
- *Trajnime dhe mentorim për mësues të kopshteve lokale mbi praktikatat gjithëpërfshirëse dhe mësimdhënien e ndjeshme ndaj traumës.*

Mbështetja psikosociale ishte një komponent thelbësor i projektit gjatë gjithë viteve të zbatimit. Praktikatat e ndjeshme ndaj traumës u integruan në aktivitetet e përditshme, duke ndihmuar fëmijët të identifikojnë dhe shprehin emocionet, të zhvillojnë strategji përballuese dhe të ndërtojnë qëndrueshmëri emocionale. Paralelisht, prindërit u mbështetën përmes takimeve javore dhe punëtorive strukturuese, të cilat kontribuan në forcimin e marrëdhënieve prind-fëmijë dhe krijimin e mjediseve familjare më të qëndrueshme.

➤ Rezultate dhe impakt

- Mbi **700 fëmijë refugjatë afganë përfituan** nga shërbimet e Qendrës Ditore gjatë gjithë periudhës së zbatimit, me një mesatare prej **40 fëmijësh të përfshirë në çdo periudhë aktive**.
- Rreth **3,100 prindër dhe kujdestarë u angazhuan** përmes takimeve javore, punëtorive tematike dhe aktiviteteve ndërgjegjëse.
- U ofruan **12 lloje shërbimesh** të integruara arsimore dhe psikosociale për fëmijët dhe familjet.
- Mbi **100 edukatorë dhe mësues parashkollorë u trajnuan dhe mentoruan** mbi praktikën gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj traumës.
- U zhvilluan **ekspozita artistike komunitare** që promovuan kreativitetin e fëmijëve dhe shkëmbimin kulturor mes komunitetit refugjat dhe atij pritës.
- U dokumentuan **rrëfime njerëzore** që pasqyruan impaktin afatgjatë të projektit në jetën e fëmijëve dhe familjeve përfituese.
- U zhvillua **një manual për arsimin joformal** në fëmijërinë e hershme, një **manual për të drejtat e fëmijëve**, si dhe një **manual për mbrojtjen dhe edukimin e tyre**, të disponueshëm në shqip dhe dari, si një burim i qëndrueshëm për prindërit dhe edukatorët.

Në tërësi, projekti kontriboi ndjeshëm në përmirësimin e aksesit në arsim cilësor dhe mbështetje psikosociale për fëmijët refugjatë afganë, fuqizimin e prindërve dhe rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të arsimit. Përmes një qasjeje të integruar dhe të qëndrueshme, iniciativa adresoi në mënyrë të drejtpërdrejtë boshllëqet ekzistuese në shërbimet e fëmijërisë së hershme në kontekste humanitare, duke ofruar një model funksional që kombinon mbrojtjen e fëmijës, arsimin joformal dhe mbështetjen emocionale. Gjithashtu, projekti kontriboi në rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve lokalë mbi rëndësinë e arsimit në fëmijërinë e hershme si një element kyç për integrimin social dhe zhvillimin afatgjatë të fëmijëve.

Foto nga aktivitetet





QËLLIMI 4: PROGRAMET EDUKATIVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE - TË RRISE NDËRGJEGJËSIMIN MBI SHËNDETIN DHE KANCERIN E GJIRIT

Projekti 4.1: Fushata ndërgjegjëse kundër kancerit të gjirit

Gjatë vitit 2025, YWCA zbatoi fushatën e 17-të ndërgjegjëse kundër kancerit të gjirit, një program gjithëpërfshirës dhe multidimensional që ndërthur ndërgjegjësimin publik, advokimin institucional, artin, sportin, kulturën dhe mobilizimin komunitar në mbarë vendin. Fushata kishte për qëllim rritjen e njohurive të publikut mbi parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, uljen e stigmatizimit që shoqëron sëmundjen, fuqizimin e zërit të pacienteve dhe të mbijetuarave, si dhe advokimin për shërbime shëndetësore dhe sociale më të aksesueshme dhe më cilësore për gratë e prekura nga kanceri i gjirit.

Duke ndërtuar mbi përvojën shumëvjeçare të YWCA në këtë fushë, fushata e vitit 2025 u konceptua si një ndërhyrje e integruar, e cila e trajton kancerin e gjirit jo vetëm si një çështje shëndetësore, por edhe si një çështje sociale, emocionale dhe të drejtash themelore të njeriut. Në qendër të fushatës u vendosën përvojat reale të grave, nevojat e tyre konkrete dhe domosdoshmëria për politika publike më gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj pacienteve.

🎀 Komunikimi publik dhe fushata në media sociale

Një shtyllë kyçe e fushatës ishte komunikimi publik dhe angazhimi në mediat sociale. Fushata online “**Unë jam e fortë**” bashkoi figura të njohura publike nga fusha të ndryshme, të cilat përdorën platformat e tyre për të përcjellë mesazhe solidariteti, force dhe rëndësie të diagnostikimit të hershëm. Përmes veprimeve të koordinuara në rrjetet sociale, fushata arriti audienca të gjera dhe të larmishme, duke kontribuar në normalizimin e diskursit publik mbi kancerin e gjirit dhe duke përforcuar narrativa pozitive mbi mbijetesën, fuqinë dhe përgjegjësinë kolektive.

<https://www.instagram.com/p/DG8Oc43NVYa/>

https://www.instagram.com/p/DG7t0JINbp_/?img_index=1

<https://www.instagram.com/p/DH6hSkwNjKu/>

Për të zgjeruar më tej shtrirjen përmes mediave tradicionale, fushata përfshiu pjesëmarrjen në programin televiziv “**Big Brother VIP**”, një nga formatet më të ndjekura në Shqipëri. Në këtë kuadër, kupona simbolikë për ekografi dhe mamografi iu dhuruan banorëve të shtëpisë, duke përdorur vizibilitetin e emisionit për të normalizuar kontrollin shëndetësor dhe për të inkurajuar gratë të vendosin prioritet shëndetin e tyre.

<https://www.instagram.com/p/DG0OFa6N5tn/>

Angazhimi komunitar dhe zëri i pacienteve

Angazhimi në komunitet u forcua përmes **tryezave të rrumbullakëta me pacientet me kancer gjiri**, të organizuara në **Elbasan, Fier, Vlorë dhe Berat**. Këto tryeza u konceptuan si hapësira të sigurt, gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse, ku gratë që jetojnë me ose pas kancerit të gjirit mund të ndanin hapur përvojat e tyre personale, sfidat dhe burimet e forcës. Vendosja e zërit të pacienteve në qendër synoi thyerjen e heshtjes dhe stigmatizimit, si dhe rritjen e solidaritetit mes grave.

Përtej vlerës psikosociale, këto tryeza shërbyen edhe si mekanizma advokimi dhe mësimi. Gratë diskutuan përvojat e tyre me diagnostikimin, trajtimin, ndjekjen pas trajtimit dhe mbështetjen sociale, duke evidentuar boshllëqe në shërbimet shëndetësore, psikologjike dhe institucionale në


nivel lokal. Të dhënat dhe reflektimet e mbledhura kontribuan në forcimin e punës advokuese të YWCA për shërbime më të aksesueshme, të integruara dhe të orientuara drejt pacienteve.



Sporti, mirëqenia dhe përfshirja e burrave si aleatë në luftën kundër kancerit të gjirit

Sporti dhe aktiviteti fizik luajtën një rol qendror në promovimin e shëndetit dhe rritjen e ndërgjegjësimit. YWCA organizoi sesionin e spinning “**Pink Ride**”, si dhe aktivitetin “**Fit for Pink**” në Parkun e Liqenit Artificial të Tiranës, duke e lidhur mirëqenien fizike me parandalimin dhe kujdesin shëndetësor. Ndërgjegjësimi u zgjerua gjithashtu përmes banderolave dhe fanellave rozë dhe të zeza të veshura nga lojtarë dhe lojtare gjatë ndeshjeve të basketbollit dhe futbollit.

Këto aktivitete kishin një dimension të qartë gjithëpërfshirës, duke angazhuar edhe *burra dhe djem si aleatë*, dhe duke përforcuar mesazhin se ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit është një përgjegjësi shoqërore e përbashkët.






🌸 Ecja simbolike për ndërgjegjësimin ndaj kancerit të gjirit

Një moment kulmor i fushatës ishte **marshimi vjetor** i organizuar këtë vit në një vend simbolik dhe shumë të frekuentuar: **Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës**. Duke e organizuar marshimin në një nga hapësirat publike më të frekuentuara në vend, fushata synoi të rrisë jehonën e mesazhit të saj për parandalimin, zbulimin e hershëm dhe solidaritetin, duke arritur jo vetëm tek pjesëmarrësit, por edhe tek udhëtarët, stafi i aeroportit dhe publiku i gjerë që ishte prezent. Marshimi mbledhi së bashku të mbijetuar të kancerit të gjirit, paciente, anëtarë të familjeve të tyre, përfaqësues të shoqërisë civile, partnerë institucionalë dhe qytetarë, duke krijuar një moment të fuqishëm të pranisë kolektive dhe të një qëllimi të përbashkët. Ecja së bashku në këtë mjedis e shndërroi aeroportin në një hapësirë ndërgjegjësimi dhe reflektimi, duke simbolizuar lëvizjen, udhëtimet dhe shpresën, në paralelizëm me rrugëtimin personal të grave të prekura nga kanceri i gjirit.

Para nisjes së ecjes, vullnetaret e YWCA of Albania shpërndanë materiale informuese dhe simbole të fushatës, si **fjongo rozë, bluza dhe broshura mbi vetëkontrollin dhe zbulimin e hershëm**, për të rritur ndërgjegjësimin ndaj sëmundjes. Aktiviteti u përmbyll me **ceremoninë e ndarjes së çmimeve “Vullnetar i Fjongos Rozë”**, një vlerësim për individë dhe institucione që me përkushtimin dhe angazhimin e tyre kanë mbështetur këtë kauzë ndër vite.

Aktiviteti ndihmoi në normalizimin e bisedave rreth kësaj sëmundjeje dhe përforcoi mesazhin se ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit duhet të jetë pjesë e jetës së përditshme publike, jo vetëm e hapësirave të mbyllura apo të specializuara. Përtej vlerës së tij simbolike, marshimi shërbeu si një thirrje publike për veprim, duke theksuar rëndësinë e kontrolleve të rregullta, diagnostikimit në kohë dhe mbështetjes së vazhdueshme sociale dhe institucionale për pacientet me kancer të gjirit.



Kultura dhe arti si mjete ndërgjegjësimi

➤ “Dëgjoni zërat tanë”

Ky aktivitet i zhvilluar në Kuvendin e Shqipërisë, përfaqësoi një nga momentet më të fuqishme të advokimit në kuadër të Fushatës së 17-të për Ndërgjegjësimin për Kancerin e Gjirit. Për herë të parë, pacientet me kancer të gjirit patën mundësinë të flasin drejtpërdrejt nga vendet e parlamentit, duke iu drejtuar vendimmarrësve brenda institucionit ku hartohen ligjet dhe politikat publike. Kjo

përmbysje simbolike e roleve i vendosi pacientet në qendër të vëmendjes politike dhe e shndërroi Kuvendin në një platformë për përvojën e jetuar, të vërtetën dhe përgjegjshmërinë.

Gjatë aktivitetit, gra që kanë luftuar me kancerin e gjirit *ndanë dëshmitë e tyre personale*, duke theksuar realitetet e diagnozës, trajtimit, kujdesit pasues dhe barrën emocionale e financiare që përballojnë pacientet dhe familjet e tyre. Duke folur me zërin e tyre dhe nga vendet e tyre në sallën e Kuvendit, ato artikuluan sfida konkrete që lidhen me aksesin në kontrole të hershme, shërbime cilësore shëndetësore, mbështetje psikologjike dhe mbrojtje sociale.

Një komponent qendror i aktivitetit ishte *prezantimi i një letre të hapur drejtuar vendimmarrësve*, në të cilën përshkruheshin qartë shërbimet kryesore që duhet të forcohen ose të krijohen për pacientet me kancer të gjirit. Letra kërkonte përmirësimin e aksesit në shërbime diagnostikuese, mbulimin më të mirë të kostove të trajtimit dhe zhvillimin e rrugëve të integruara të kujdesit shëndetësor të orientuara nga pacienti. Duke e dorëzuar zyrtarisht këtë letër në Kuvend, fushata i përktheu zërat e pacienteve në kërkesa konkrete advokimi, duke përforcuar mesazhin se ndryshimet domethënëse në politika duhet të bazohen në nevojat dhe përvojat reale të atyre që preken drejtpërdrejt.





➤ **Podkasti skenik "Tefta Tashko Koço - Kënga Ime Ndaj Nat' Here"**

Si pjesë e dimensionit kulturor dhe ndërgjegjësues të fushatës, u organizua edhe një koncert i dedikuar jetës dhe trashëgimisë së Tefta Tashko Koços, duke bashkuar artin, kujtesën dhe advokimin në një mënyrë të fuqishme dhe emocionalisht domethënëse. Koncerti e nderoi Tefta Tashko Koçon jo vetëm si *një nga sopranot më të njohura shqiptare*, por edhe si *një grua që u diagnostikua me kancer gjiri*, duke e bërë historinë e saj thellësisht të lidhur me mesazhin e fushatës. Përmes muzikës klasike dhe interpretimit artistik, koncerti krijoi një hapësirë reflektimi që theksoi dimensionin njerëzor të kancerit të gjirit — thellësinë emocionale, betejat personale dhe forcën e qëndrueshme. Duke lidhur trashëgiminë kulturore me advokimin bashkëkohor për shëndetin, aktiviteti ndihmoi në krijimin e një ure mes brezave dhe në arritjen e audiencave që zakonisht nuk angazhohen me fushata ndërgjegjësimi.

Në të njëjtën kohë, koncerti pati edhe një ndikim të drejtpërdrejtë social. Të gjitha fondet e mbledhura nga shitja e biletave u dedikuan për të mbështetur shërbimin e këshillimit psikologjik të YWCA për pacientet me kancer të gjirit dhe familjarët e tyre, duke ndihmuar në adresimin e nevojave shpesh të anashkaluara emocionale dhe të shëndetit mendor që lidhen me këtë sëmundje. Duke kontribuar në këto shërbime, publiku u bë mbështetës aktiv i grave dhe familjeve që përballen me sfidat psikologjike të diagnozës, trajtimit dhe mbijetesës.

https://www.instagram.com/p/DQNFc6BiBNI/?img_index=1

➤ **“Jam më e bukur se beteja ime”**

Ky aktivitet, i organizuar në bashkëpunim me *Coin Tirana*, krijoi një hapësirë pozitive dhe mbështetëse ku gratë patën mundësinë të ndanin përvojat e tyre, të afirmnin identitetin dhe bukurinë e tyre përtej sfidave të sëmundjes dhe të ndiheshin të vlerësuara nga komuniteti. Përmes këtij eventi u synua të sfidohen stereotipet dhe perceptimet shoqërore që shpesh e lidhin kancerin vetëm me humbje apo dobësi, duke theksuar se gratë që kalojnë këtë përvojë mbeten të forta, të bukura dhe plot jetë. Aktiviteti promovoi pozitivitetin trupor dhe vetëimazhin, duke inkurajuar gratë të pranojnë dhe të festojnë trupin e tyre edhe pas ndryshimeve fizike që mund të sjellë trajtimi.





➤ Libri “12 Histori Kurajoje”

Zërat e pacienteve u fuqizuan më tej përmes librit “12 Histori Kurajoje”, i cili u krijua për të sjellë në vëmendje përvojat e tyre, duke ofruar një pasqyrim të sinqertë dhe intim të realiteteve emocionale, sociale dhe mjekësore të kancerit të gjirit, ndërkohë që thekson qëndrueshmërinë, dinjitetin dhe forcën e brendshme. Përmes rrëfimeve personale, libri hedh dritë mbi faza të ndryshme të rrugëtimit me kancerin e gjirit, nga diagnoza dhe trajtimi deri tek mbijetesja, duke kapur jo vetëm momentet e frikës dhe pasigurisë, por edhe shpresën, solidaritetin dhe transformimin. Duke ndarë këto përvoja të jetuara, “12 Histori Kurajoje” kontribuon në thyerjen e stigmës dhe heshtjes rreth kancerit të gjirit, duke inkurajuar dialog të hapur dhe një kuptim më të gjerë publik për sfidat që përballin gratë gjatë këtij rrugëtimi. Promovimi i librit u realizua përmes aktiviteteve të organizuara në disa qytete, duke krijuar hapësira të sigurt dhe reflektuese për dialog mes pacienteve, familjarëve, profesionistëve dhe komunitetit më të gjerë.

Këto aktivitete u dhanë mundësi autoreve dhe kontribuesve të ndajnë historitë e tyre drejtpërdrejt me publikun, duke nxitur empati dhe lidhje njerëzore, ndërkohë që përforconin mesazhet kryesore për zbulimin e hershëm, mbështetjen psikologjike dhe rëndësinë e kujdesit gjithëpërfshirës.



➤ Instalacioni “Dielli i ditës tjetër”

Fushata u përmyll me një ndërhyrje të fuqishme të artit publik të titulluar **“Dielli i Ditës Tjetër”**, e instaluar pranë Mozaikut ikonik “Shqipëria”. Ky instalacion e transformoi një simbol të njohur kombëtar në një hapësirë reflektimi, duke përdorur artin si një mjet për të përballur, humanizuar dhe ndërgjegjësuar për realitetet e kancerit të gjirit në një mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa kompromis. Në këtë instalacion, figura qendrore femërore e mozaikut u riimagjinua si një grua pa flokë dhe me një gji të hequr, duke ofruar një përfaqësim të fuqishëm vizual të ndikimit fizik të kancerit të gjirit dhe trajtimeve të tij. Ndërhyrja ftoi kalimtarët të ndaleshin, të reflektonin dhe të përfshiheshin emocionalisht me përvojat e jetuara të grave të prekura nga kanceri i gjirit.

Përmes këtij instalacioni, fushata *theksoi rolin e artit në ndryshimin social*, duke përdorur shprehjen vizuale për të amplifikuar rrëfimet e pacienteve dhe për të promovuar empatinë. “Dielli i Ditës Tjetër” shërbeu si një kujtesë e qëndrueshme për kurajon e grave që përballen me kancerin e gjirit dhe përforcoi përgjegjësinë kolektive për të mbështetur zbulimin e hershëm, kujdesin gjithëpërfshirës dhe solidaritetin me të gjitha ato që preken nga kjo sëmundje në shoqërinë shqiptare.

<https://www.instagram.com/p/DQ4QCY1jVLG/>

https://www.instagram.com/p/DRIgL4GDcju/?img_index=2

Në tërësi, fushata e vitit 2025 arriti të kombinojë me sukses komunikimin mediatik, dialogun me komunitetin, aktivitetet sportive dhe të mirëqenies, shprehjen kulturore dhe advokimin institucional. Përmes kësaj qasjeje të integruar, fushata forcoi ndërgjegjësimin publik, inkurajoi zbulimin e hershëm, amplifikoi zërat e pacienteve dhe përforcoi angazhimin kolektiv për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe të shërbimeve për gratë e prekura nga kanceri i gjirit në të gjithë vendin.